Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/0844

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Vedat Poterqoi - Kryetar, duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) "Profitech" SH.P.K.,Lot 3 kundër Vendimin për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit të Kompania Ujësjellësi Rajonal Prishtina Sh.A. në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me kemikate për trajtimin e ujit" me numër të prokurimit 70433736-23-7164-1-2-1, me 29/12/2023, mori:

Vendim

1. **Aprovohet**, si pjesërisht e bazuar ankesa e OE "Profitech" SH.P.K., Lot 3 me nr. 2023/0844 , e datës 27/10/2023, kurse vendimi i AK Kompania Ujësjellësi Rajonal Prishtina Sh.A.. lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me kemikate për trajtimin e ujit" me numër të prokurimit 70433736-23-7164-1-2-1 anulohet, ndërkaq aktiviteti i prokurimit kthehet në **Rivlerësim**.

2. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarrë masa ndaj AK për mos respektim të vendimit sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të LPP.

3. Kthehen mjetet e deponuara në emër të taksës tarifore për parashtrimin e ankesës në llogarinë e Operatorit Ekonomik "Profitech" SH.P.K.,

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 25.07.2023, Kompania Ujësjellësi Rajonal Prishtina Sh.A. në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me "Furnizim dhe instalimi i pajisjeve për klimatizimë" me numër të prokurimit 70433736-23-7164-1-2-1. Ndërsa me datën 10.10.2023 Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues ku ka shpërblyer me kontratë për "Aset shpk dhe Grami shpk".

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur me llojin e kontratës furnizim dhe me vlerë të parashikuar të kontratës 75,000.00€.

Me 16.10.2023, OE "Profitech" SH.P.K., ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Me 17.10.2023, Autoriteti Kontraktues ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 27.10.2023, OSHP ka pranuar ankesën nga OE "Profitech" SH.P.K., me nr. 844/23 lidhur me aktivitetin "Furnizim me kemikate për trajtimin e ujit" me numër të prokurimit 70433736-23-7164-1-2-1

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues"Profitech" SH.P.K., janë parashtruar si në vijim**:**

Pretendimi i parë (I): *"Bazuar në "Njoftimin mbi Vendimin e Autoriteti Kontraktues" të datës: 10.10.2023, vendimi i marr nga Komisioni Vlerësues është i pa bazuar; Lot 3: Polielektrolit anjonik Ne në "Kërkesën për Rishqyrtim" të dërguar më datë 28.09.2023 për OE të rekomanduar për kontratë për Lot 3: Polielektrolit anjonik e kemi theksuar se në dokumentet të cilat janë dërguar nga OE i rekomanduar për kontratë mungojnë të dhënat: Pesha molekulare: E lartë dhe Ngarkesa relative: E ulët, te cilat janë kërkuar në ANEKS 1 të dosjes së tenderit. Përgjigja në kërkesën për rishqyrtim të datës 06.10.2023 nga ana e AK-së se: Mungesa e shprehjeve e "lartë" "e ulet" nuk nënkupton se mungon specifikacioni, pasi qe ai ka qene i dorëzuar. Ne sqarimin e kërkuar, prodhuesi ka deklaruar se materiale i kërkuar ne lot 3 i plotëson këto kërkesa "e larte" e " e ulet" (shiko dëshmitë 1 dhe 2) Ky vendim nuk qëndron dhe është i pa bazë, përderisa të dhënat e kërkuara: Pesha molekulare: E lartë dhe Ngarkesa relative: E ulët, kanë munguar në dokumentet të cilat OE i rekomanduar për kontratë i ka dorëzuar si pjesë të tenderit. Në dokumentet: "Certifikat Kvaliteta" Dhe "Sigurnosno-Tehnicki List" nuk janë të specifikuara këto të dhëna. Ku në bazë të Udhezuesit Nr-001_2023: Është dorëzuar katalogu por mungon specifikacioni teknik për mallrat e ofruara Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm Që do të thotë se Operatorit Ekonomik të rekomanduar për kontratë i mungon specifkacioni teknik dhe do duhej që ti refuzohej tenderi pa kërkuar informacion të mëtejshëm. Kjo bie ndesh edhe me përgjigjen e AK-së të cilën e ka dërguar për LOT 1 Permanganat Kaliumi ku është përgjigjur se: Ne sqarimin e dhëne, OE vetëm kishte komentuar se ne vend te standardit EN12672/2000 tani është standardi EN12672/2016 por nuk*

kishte dorëzuar certifikatën apo ndonjë certifikate te kualitetit, e cila dëshmon se prodhuesi plotëson standardin për ketë artikull. E njëjta vlen edhe për LOT 3 Polielektrolit anjonik; OE i rekomanduar për kontratë vetëm ka komentuar se i plotëson kërkesat "e larte" e " e ulet" por nuk ka dorëzuar certifikate apo ndonjë dokument ekzistues i cili dëshmon se artikulli në fjalë i plotëson kërkesat e kërkuara në Aneks 1 të dosjes së tenderit: Pesha molekulare: E lartë dhe Ngarkesa relative: E ulët. Llojin e Kemikalit të kërkuar Polielektorlit anjonik CEN-1407:2008 nga ana e AK-së sipas specifikave teknike të kërkuara në ANEKS 1 të dosjes së tenderit Prodhuesi "Aqua V.M.V. doo" nuk e ka në prodhim, për këtë arsye OE nuk ka paraqitur katalog të prodhimit të tij por vetëm ka deklaruar se e prodhon dhe atë duke mos i paraqitur disa nga specifika teknike, kjo nuk do të thotë se e prodhon ketë lloj të kemikalit, për shkak se kemikalet duhet te certifikohen nga Trupat e Sigurisë të Kualitetit për të dhëne leje për prodhim të secilit kemikal sepse këtu kemi të bëjmë me kemikale për trajtim të ujit të pijshëm. Siç e kemi theksuar edhe në Kërkesën tonë për Rishqyrtim të dërguar më datë 28.09.2023 e përsërisim se: Grupi i OE i rekomanduar për kontrate ka ofruar një dokument te ashtu quajtur "CERTIFIKAT KVALITETA" – Certifikatë të kualitetit në tL cilin dokument kryesisht janë përshkruar specifikacionet teknike të shënuara vet (copy –paste) të cilat nuk paraqesin katalog, broshure apo manual ku mund te vërtetohen – krahasohen specifikat teknike, në bazë të kësaj shihet se Prodhuesi nuk i plotëson specifikat e kërkuara ne ANKES 1, të dhënat nuk e dëshmojnë tipin e ofruar dhe nuk i plotësojnë kriteret e kërkuara ne Specifikimet Teknike te Detyrueshme ANEKS 1 të dosjes së tenderit. Sa i përket kemikaleve Certifikatë e Kualitetit nuk ekziston, Certifikatë e Kualitetit për Kemikale është Certifikata e Analizës (COA). Certifikata e Analizes është dokument i cili lëshohet nga Trupat e Sigurisë te Kualitetit të cilat konfirmojnë që një produkt i rregulluar plotëson specifikimin e produktit të tij. Ku zakonisht përmbajnë rezultatet aktuale të marra nga një testim i kryer si pjesë e kontrollit të kualitetit të një serie individuale të një produkti. (pas prodhimit të një produkti). Që do të thotë se dokumenti i ashtu quajtur Certifikate e Kualitetit e dorëzuar nga OE i rekomanduar për kontrate nuk është dokument kredibil dhe nuk vërteton rezultatet aktuale të marra nga një testim pas prodhimit të një produkti. Dokumenti në fjalë nuk duhet të merret parasysh sepse është dokument i cili është përgatitur gjatë fazës së tenderimit dhe nuk është dokument ekzistues i prodhuesit. Grupi i OE i rekomanduar për kontrate ka ofruar edhe një dokument: SIGURNOSNOTEHNICKI LIST – Safety Data Sheet, në të cilin dokument janë të specifikuara vetëm dy prej të dhënave teknike: pH: 7,1 (0,5%-tna otopina) Gustoca: 0,4 – 0,8 g/cm3 Po në këtë dokument mungojnë të dhënat Teknike të kërkuara në ANEKS 1 të dosjes së tenderit. Më e rëndësishme për tu theksuar është se në ANKES 1 të dosjes se tenderit është kërkuar qe produkti të ketë Standardin Evropian CEN-1407:2008 i cili dëshmon se polielektroliti do të përdoret për trajtimin e ujit të destinuar për konsum njerëzor. Nga kjo vërtetojmë se OE i rekomanduar për kontrate nuk ka ofruar dokumente kredibile nga prodhuesi në të cilat mund të verifikohen të dhënat teknike gjë që do duhej që OE i rekomanduar për kontratë të shpallet i papërgjegjshëm bazuar në: PJESA A: PROCEDURAT E TENDERIMIT 3. Specifikimet teknike të detyrueshme 3.1 Furnizimet duhet të jenë në pajtim të plotë me specifikimet teknike të parashtruara në këtë Dosje të Tenderit, shih Aneksin 1, dhe në përputhshmëri në të gjitha aspektet me vizatimet, sasitë, modelet mostrat, matjet dhe udhëzimet tjera. Kjo do të demonstrohet me dorëzimin e provave të dokumentuara të përcaktuara në FDT.

3.2 Cilido specifikim që nuk është në përputhshmëri me specifikimet teknike do te diskualifikoj tenderin.”

Duke u referuar pretendimeve si më sipër “Profitech” SH.P.K., konsideron se Autoriteti Kontraktues ka shkelur nenin 7, 28, 59, te LPP Neni 19 – Specifikimet Teknike ne Rregullore Nr.001_2022 për prokurimin publik Udhëzues Nr-001_2023 duke i propozuar qe ankesën ta aprovoj si te bazuar dhe lenden ta kthej ne rivlerësim.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 01/11/2023 ka autorizuar ekspertin për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 844/23, ndërsa me datë 13/11/2023 është dorëzuar raporti i ekspertit me nr. 2023/0844 me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK rreth rekomandimeve të raportit të ekspertit shqyrtues, “Autoriteti kontraktues nuk pajtohet . Ndërsa OE Pajtohet me raportin e eksperti shqyrtues”

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për te vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore ne kuptim te nenit 24 paragrafi 1 te Rregullores së Punës së OSHP-së duke marr parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritor lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtresat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE “Profitech” SH.P.K., eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2023/0844 ka vlerësuar si në vijim:

-Konstatimi i ekspertes shqyrtuese - (I): *“Përderisa tenderi është shpallur për Furnizim me Kemikate për trajtim të ujit të pijes dhe duke ditur se sa sensitive është një proces teknologjik i tillë dhe pas krahasimit të specifikimeve teknike të të dy operatorëve ekonomik ‘’Profitech’’ dhe Grupit të OE ‘’Aset & Grami’’ karshi përmbushjes së kritereve për specifikim teknik të LOT 3; nxjerr këtë konkluzion: 1. Specifikimi teknik i OE ‘’Profitech’’, është në harmonizim me shpalljen e KUR ‘’Prishtina’’ (Autoriteti Kontraktues). Përderisa, grupi OE ‘’Aset & Grami’’ është në harmonizim vetëm me dy specifika të shpallura nga AK (Certifikat Kvaliteta): 1.2 Vlen të ceket edhe një e gjetur (jo korrelacion), parametri (edhe pse nuk figuron në AK): Aroma në dokumentin ‘’Sigurnosno-Tehnicki List’’ është ‘’shumë e paqartë’’ (org. MIRIS= vrlo nejasen). Përderisa në dokumentin ‘’Certifikat Kvaliteta’’ është ‘’pa aromë’’ (org. MIRIS= bez mirisa). 2. Sa i përket përmbushjes së standardeve: Në grupin e OE ‘’Aset & Grami’’ standardet për LOT 3 është mospërputhje e standardeve: 2.1. në ‘’Sigurnosno-Tehnicki List’’,*

reagjenti i LOT 3 edhe pse me emër tregtar ''Aquaflok 2464 PWG'' është 1272/2008 (CLP); përderisa 2.2. në ''Certifikat Kvaliteta'' standardi është i harmonizuar sikurse specifika të shpallura nga AK CEN 1407:20083. Indikatorë i fuqishëm për mua janë edhe referencat e bashkangjitura: 3.1 OE ''Profitech'' vetëm për LOT 3, i ka të bashkangjitura në dosje këto referenca: 3.1.1. KEK (30.12.2020) 3.1.2. KUR –Prishtina (09.12.2020) 3.1.3. KUR-Gjakova (13.01.2023 dhe 14.06.2023) Përderisa grupi i OE ''Aset & Grami'', për LOT 3 specifikisht për reagjentin ***Polielektrolit anjonik,*** *nuk ka të bashkangjitur asnjë referencë.P.S është një referencë që reagjenti ka sërish emër tregtar (dhe dyshoj që është fjala për polimerin* ***Polielektrolit anjonik****)20015834 Nalko ST 40; 002030004 3D TRASAR 3DT 249 Birraria Peja ??* ***Vendimi i AK për aktivitetin e prokurimit për LOT 3 duhet te anulohet për arsye të jo përmbushjes të një serie të kritereve nga specifikimi teknik, përderisa OE ''Profitech'' i ka në korrelacion specifikimet teknike me kriteret për specifikim teknik të shpallur nga KRU ''Prishtina'' (Autoriteti Kontraktues)."***

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Në këtë mënyrë është gjetur se Autoriteti Kontraktues nuk ka vepruar në përputhje me dispozitat ligjore për prokurimin publik dhe kërkesat e Dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me kemikate për trajtimin e ujit" me nr. të prokurimit: 70433736-23-7164-1-2-1.

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, si dhe përgjigjes së palëve në procedurë ndaj raportit të ekspertizës, ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik aprovohet si pjesërisht e bazuar.Rrjedhimisht, Paneli Shqyrtues duke marre parasysh përshkrimin dhe faktet e lartpërmendura dhe pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të operatorit ekonomik ankues, analizës konkrete dhe dokumentacionit të lëndës, ankesën e operatorit ekonomik e sheh si pjesërisht të bazuar ngase nuk pajtohet në tërësi me të gjeturat e ekspertëve shqyrtues dhe nuk e kualifikon OE e rekomanduar për kontratë si të papërgjegjshëm, për shkak se në përgjigjen e AK ndaj raportit të ekspertizës ka lënë dyshime se ekspertët shqyrtues mund të ju ketë ikur ndonjë gjë gjatë trajtimit të kësaj lënde dhe paneli shqyrtues është laik në këtë fushë, si dhe përshkak se kemi të bëjmë me një natyrë të aktivitetit për të cilën është shumë delikate dhe meriton të trajtohet drejtë për shkak të interesit publik, atëherë paneli shqyrtues e obligon AK që në fazën e ri-vlerësimit ta formoj një komision nga specialist të kësaj fushe dhe natyre te aktivitetit dhe vlerësimin e ofertës së OE të rekomanduar për kontratë dhe ofertave të cilat kanë rezultuar me vendimin e parë si të përgjegjshme, ta bëjnë konform kushteve të përcaktuara në Dosjen e Tenderit dhe të veproj në plotni me dispozitat ligjore të LPP-së.

Panelit Shqyrtueska vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryetar i Panelit Shqyrtues

Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- AK - **KOMPANIA UJËSJELLËSI RAJONAL PRISHTINA SH.A.**
- OE - **" Profitech " SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: